

Pt. 17813/1 10.12.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 838/1 prot.

Shkodër, më 10.12.2020

LËNDA: Mbi vendimin Nr.54, datë 27.11.2020 të Këshillit Bashkiak Shkodër.

KËSHILLI BASHKIAK SHKODËR

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr.107 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", të aktit normativ nr.3 datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar" të ndryshuar, Ligjit nr.15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 54/e, neni 55/4, neni 64/c, ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr.105/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.79/2017 "Për sportin", shqyrtoi Vendimin¹ nr.54, datë 27.11.2020 të Këshillit Bashkiak Shkodër "Mbi miratimin për shitjen me ankand të aksioneve të klubit të futbollit "Vllaznia" sh.a në masën 100%".

Pas analizimit, konstatohet si vijon:

Vërehet se vlerësimi i bërë nga shoqëria auditimit nuk përfshin periudhën vitet 2018-2019 (shkresa nr.6497 datë 09.5.2018).

Dokumentet standart tip të procedurës së ankandit bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nuk janë tagër i organit kolegjal, pasi kjo është procedurë e autoritetit shitës referuar ligjit Nr.9874 dt.14.02.2008 "Për ankandin publik" i ndryshuar dhe procedurës së parashikuar në VKM Nr.1719 datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik" i ndryshuar.

Në vëmendje të Autoritetit shitës, kreu II, pika 2 mbi llogaritjen e vlerës fillestare të ankandit.

Për sa trajtuar, Prefekti konfirmon në parim dhe mbështet procesin e privatizimit të Klubit të Futbollit "Vllaznia" sh.a në masën 100%, kërkesë e ligjit Nr.105/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.79/2017 "Për sportin", duke ju lejuar procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

¹ Vërehet se projekt-vendimi i paraqitur nga bashkia Shkodër nuk është konform rregullores të këshillit Bashkiak Shkodër, nen 27, pika 2 & 3 miratuar me VKB nr.57, date 2.11.2016 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak Shkodër", tagër i sekretarit të këshillit bashkiak.

